



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:171052
Datë: 17.04.2024
Numri i dokumentit: 05582761

Ac.nr.8444/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Lumni Sallauka dhe Hunaida Pasuli-anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Q..... N..... nga fshati Prekaz i Epërm, komuna Skenderaj, të cilin e përfaqëson me autorizim Q..... R..... avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim të Rriturve nga Prishtina Rr”Agim Ramadani” pn., për kompensim të ushqimit gjatë punës në vlerën prej 238.00 euro, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.558/2020, të datës 22.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17.04.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHEN SI E PA THEMELTË, ankesa e të paditurës, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.558/2020, i datës 22.08.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.558/2020 të datës 22.08.2022, e aprovuar si të bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses Q..... N..... nga fshati Prekaz i Epërm, komuna Skenderaj. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar të paditurën Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim të Rriturve që paditëses në emrin e kompensimit për ushqimin për pranin në punë për periudhën kohore nga data 12.03.2020 deri me datën 01.03.2021 gjegjësisht për 119 ditë pune t’ia kompensoj shumën prej 238.00 euro (për secilën ditë të pranisë në punë shumën prej nga 2 (dy) euro. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka obliguar të paditurën që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë: për hartim të padisë 104 euro, taksë për padi shumën prej 20 euro dhe për një përfaqësim të avokatit në një

seancë shumë prej 135 euro, të gjitha këto shuma duhet të paguhet në afatin prej 15 nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të shkeqe esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta prish aktgjykimin e atakuar duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Paditësja ka paarshtuar përgjigje në ankesë, me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 par.1, pika d), në lidhje me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës, është e pathmeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, me datën 02.12.2020, ka ushtruar padi për kompensimin e shujtave për praninë në punë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditësit dhe të obligohet e paditura që paditësit t'ia përmbushur detyrimin ndaj tij për pagesë të shujtave ditore për ditët që ka qenë prezent në punë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se e njëjta është e pasafatshme pasi që paditësi i referohet kontratës kolektive, e cila ka skaduar në vitin 2018. Prandaj kërkesat në mjete monetare janë të parashkruara, andaj mbi këtë bazë i kërkojmë gjykatës refuzimin e kërkesëpadiës si të pa bazuar. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor, dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.558/2020 të datës 22.08.2022, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi është mësimdhënës në Qendrën e Kompetencës në Skenderaj në kuadër të Agjencisë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim të Rriturve. Nga vërtetimi i lëshuar nga e paditura për ditët e pranisë në punë për paditësen, gjykata konstaton se paditësja ka punuar gjithsej 119 ditë pune dhe këto ditë pune të llogaritura me shujtën ditore nga nr.2 (dy) në ditë e arrin vlerën prej 238.00 euro. Në fund gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar sipas nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektiv të Arsimit në Kosovë të vitit 2017, ndërsa për sa i përket shpenzimeve procedurale, gjykata vendosi sipas nenit 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Aktgjykimi i atakuar me ankesë është i rregullt në pikëpamje të strukturës dhe përmbajtjes duke përfaqësuar kështu një vendim i cili është koherent në pikëpamje logjike dhe juridike duke eliminuar çfarëdo kontradikte për ta kualifikuar si kundërthënës. Mënyra e zhvillimit të procedurës dhe e hartimit të vendimit nga gjykata e shkallës së parë kanë garantuar një proces të drejtë dhe të paanshëm duke u mbështetur për përfundimin e saj në themelin faktik dhe juridik të çështjes.

Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore e të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor.

Gjykata e Apelit i refuzon si të pabazuara pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se nënshkruarit e Kontratës Kolektive siç janë MASHT-i, SBASHK-u dhe Ministria e Financave nuk janë angazhuar asnjëherë për zbatimin e dispozitave që janë implikime financiare e kjo për faktin se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë Kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata e Apelit vlerëson se, në rastin konkret është obligim i të gjitha institucionet edukativo arsimore publike dhe private të zbatojnë këtë kontratë, pasi që e njëjta është nënshkruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe SBASHK-ut, prej së cilës rrjedhin detyrime të cilat është e obliguar e paditura t'i përmbush, gjegjësisht përgjegjësia për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe të drejtat tjera të cilat u përkasin punonjësve të arsimit ku sipas nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë është përcaktuar zbatimi i

kësaj kontratë “ 1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Kontrata kolektive e përgjithshme. 1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Para universitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK - ut. 1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT - in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo - arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, thëniet e të paditurës se kërkesëpadia duhet refuzuar, nga shkak se nënshkruesit e marrëveshjes nuk ia kanë siguruar të paditurit mjetet për buxhet për pagesë nuk janë të bazuara, duke marrë parasysh se ai shkak i cili do ta lironte të paditurën nga përgjegjësia, nuk është paraparë as me dispozitat e ligjit e as të Kontratës kolektive, e as përfaqësuesi i të paditurit nuk ka provuar në ndonjë mënyrë tjetër se thëniet e tij janë të bazuara.

Po ashtu, Gjykata e Apelit i refuzon si të pathemelta pretendimet ankimore të palës së paditur e cila në ankesë thekson se paditësi nuk i ka shtjerr mjetet e brendshme ankimore në kuptim të nenit 78 dhe 79 të Ligjit të Punës 03/L-212, për faktin se në shkesat e lëndës gjenden prova siç është kërkesa me nr. Protokollar 2112 e datës 08.09.2020 ku vërtetohet se paditësi i është drejtuar të paditurës për kompensimin e shujtave për ditët prezentë në punë, ndërsa e paditura e ka refuzuar një kërkesë të tillë me arsyetimin se pasi që përmbushja e detyrimit për kompensim të shujtave nuk është paraparë në Ligjin për Buxhet e as në buxhetin e të paditurës e paditura nuk mund ta përmbushë këtë obligim. Megjithatë, Gjykata e Apelit thekson se e drejta e punës është kategori kushtetuese e garantuar me konventa ndërkombëtare dhe me ligj, dhe në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (*kërkesat materiale*) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, (sepse në rastin konkret nuk bëhet fjalë për procedurat për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës ku aplikohet neni 78, neni 79 dhe neni 82 i Ligjit të Punës) e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësit në asnjë rrethanë nuk mund ti mohohet e drejta për të kërkuar mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike tek e paditura.

Gjykata e Apelit, ka vlerësuar pretendimin ankimor të palës së paditur e cila ka theksuar se paditësit nuk i takon kompensimi i cili parashihet me Kontratë Kolektive sepse nuk është anëtar i SBASHK-ut dhe një pretendim të tillë e refuzon si jo të drejtë ngase sa i përket kushtit për antarësimin në SBASHK, dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë nuk mund të aplikohet ngase do të ishte diskriminuese dhe do të ishte një kushtëzim për anëtarësim sindikal për realizimin e të drejtave që rrjedhin nga kjo kontratë dhe do të cenonte të drejtën apo lirinë e abonimit në organizatat sindikale dhe do të cenonte parimin e barazisë të përcaktuar me nenin 24 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit që në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë t'ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç është vërtetimi lidhur me ditët e pranisë në punë për paditësin, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të paditurës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.8444/2022, datë 17.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Ardian Ajvazi